KUSHTET E PËRDORIMIT

Përdorimi i faqes së internetit të myWorld Albania Shpk, një shoqëri e regjistruar në Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, Shqipëri (***myWorld***) bazohet mbi këto Kushte Përdorimi. Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit dhe të gjitha dokumentet ligjore shtesë gjithashtu zbatohen për Anëtarët e myWorld. Më te, Marrëveshja për Kompanitë Partnere dhe të gjitha dokumentet ligjore shtesë zbatohen gjithashtu për Kompanitë Partnere. Përdoruesit e kësaj faqe të internetit bien dakord me këto Kushte dhe Afate, dhe bien dakord që ***myWorld*** nuk mund të jetë përgjegjës për përdorimin e kësaj faqe. ***myWorld*** rezervon të drejtën për të ndryshuar dhe azhurnuar këto Kushte dhe Afate në çdo kohë.

myWorld bën më të mirën e vet për të paraqitur informacione korrekte dhe aktuale në këtë faqe interneti. Detajet dhe informacionet që janë në këtë faqe, sidoqoftë, nuk janë të garantuara. Për këtë arsye, përdoruesit e kësaj faqeje, bien dakord që rrezikun nga përdorimi i kësaj faqeje interneti dhe përmbajtja e saj të mbahet prej tyre. ***myWorld*** nuk mban përgjegjësi për dëmet që lindin nga përdorimi ose mos-përdorimi i kësaj faqe në internet dhe gjithashtu nuk është përgjegjës për çdo gabim ose përjashtim.

Të gjitha imazhet, tekstet dhe audiot, si dhe animacionet, videot, etj., dhe të gjitha pjesët e tjera të kësaj faqeje në internet janë të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe, ato, qoftë në tërësi apo pjesërisht, nuk mund të shpërndahen, shkarkohen, ndryshohen, ripërdoren, ridrejtohen ose përdoren për qëllime të tjera pa autorizim paraprak me shkrim. Skedarët në zonën e brendshme të shkarkimit mund të përdoren vetëm për qëllime private.

myWorld rezervon të drejtën të përjashtojë individë nga shërbimi dhe / ose nga shërbimi i postës nëse ka ndonjë arsye të fortë për të kryerkëtë veprim.

Për aktivitete ose informacione të mundshme të paligjshme nga çdo lidhje (*link)* elektronik që çojnë nga kjo faqe në faqet e tjera në internet, si dhe për përmbajtjen që krijohet nga përdoruesit në forumet tona, ***myWorld*** mban përgjegjësi vetëm nëse ka qënë në dijeni dhe në rastet kur ***myWorld*** nuk bllokon apo heq menjëherë informacionin apo bllokon aksesimin e tij. Përmbajtet me natyrë diskriminuese, ofenduese, të dënueshme moralisht ose të paligjshme mund të hiqen nga ***myWorld*** në çdo kohë.

Për çdo pyetje të mëtejshme lidhur me Kushtet dhe Afatet e Përdorimit dhe Kushtet e Afatet e Përgjithshme të Biznesit, lutemi na kontaktoni në:

myWorld Albania Shpk
Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre,
Kati i 13-të, 1000,
Tiranë, Shqipëri
Email: service.al@myworld.com
Regjistruar në Republikën e Shqipërisë: NUIS: M11311050A

PËRJASHTIME

1. myWorld Albania Shpk, një shoqëri e regjistruar në Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, Shqipëri (***myWorld***) nuk mban asnjë përgjegjësi të çfarëdo lloji për statusin, korrektësinë, plotësinë, ligjshmërinë dhe / ose cilësinë e informacionit të dhënë. Kjo vlen gjithashtu për të gjitha produktet dhe shërbimet e ofruara në këtë faqe në internet, përfshirë përshkrimet e produkteve, çmimet dhe informacionin e dhënë në lidhje me partnerët e kontaktit të ***myWorld***. Gabimet teknike dhe / ose puna e mirëmbajtjes, si dhe shkaqe të tjera (të tilla si ri-lëshimi i faqes në internet) mund të çojnë në një humbje të shkurtër ose më të gjatë të aksesit së faqes së internetit. ***myWorld*** nuk mund të garantojë aksesin dhe përdorimin e faqes në internet. ***myWorld*** nuk është përgjegjës për ndonjë dëm material ose jo-materiaë(të tilla si humbja nga fitimi, shpenzime kontraktuale, dëme për shkak të humbjes së të dhënave, pretendime bazuar në pasurimin e padrejtë, tarifat ligjore ose tarifat e ndërmjetësimit të kontratës), të cilat ndodhin për shkak të përdorimit të informacionit të dhënë ose duke përdorur informacion të pasaktë ose jo të plotë, përveç nëse ***myWorld*** shkakton dëmin me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë. Të gjitha ofertat janë objekt ndryshimi dhe nuk janë detyruese. ***myWorld*** rezervon shprehimisht të drejtën për të ndryshuar, shtuar, fshirë ose ndaluar publikimin e kësaj faqeje interneti, tërësisht ose pjesërisht, për një periudhë të kufizuar apo komplet, pa njoftuar në lidhje me këtë.

2. Më tej, ***myWorld*** nuk mban përgjegjësi për *hyperlinks* (faqe e tejlidhur) apo përmbajtjen e tyre. ***myWorld*** nuk mban asnjë lloj përgjegjësie për statusin, korrektësinë, plotësinë, ligjshmërinë dhe / ose cilësinë e *hyperlinks*. Çdo përgjegjësi bie mbi ofruesin e *hyperlinks* . ***myWorld*** nuk ka kontroll mbi strukturën ose përmbajtjen aktuale ose të ardhshme të këtyre *hyperlinks*. Për këtë arsye, ***myWorld*** distancohet shprehimisht nga përmbajtja e të gjitha *hyperlinks* të cilat janë ndryshuar pasi është shtuar *link* (lidhja), si dhe nga ndërhyrjet e kryera nga palët e treta në librin e mbresave/komenteve të ***myWorld***, forumet e diskutimit dhe listat e postës. Kontrolli i vazhdueshëm i faqeve të internetit të ndërlidhura nuk është i arsyeshëm pa shënimin thelbësor të shkeljeve ligjore. Kur ***myWorld*** të marrë dijeni për një shkelje të tillë ligjore, *hyperlink*-u do të hiqet menjëherë.

3. Përdorimi i kësaj faqeje në internet lejohet vetëm për qëllime informimi dhe qëllime private dhe profesionale. Të gjitha përmbajtjet e kësaj faqe në internet mbrohen nga e drejta e autorit. Kjo pavarësisht nëse përmbajtja ofrohet kundrejt një tarife apo falas. Çdo lloj forme dublimi, përdorimi, dhënie me qira, huazimi, publikimi ose përdorimi tjetër i çfarëdo lloj forme kërkon autorizimin me shkrim të ***myWorld***. Shkeljet e kësaj kërkese mund të rezultojnë në pasoja ligjore, veçanërisht të zbatueshme në lidhje me markat tregtare, të drejtën e autorit dhe ligjin e konkurrencës. ***myWorld*** ruan në mënyrë të qartë të gjitha të drejtat e autorit, të markës tregtare dhe të drejtat e përdorimit (të drejtat e përdorimit të veprës/markës dhe lejen e përdorimit të veprës/markës) për të gjitha përmbajtjet e paraqitura në këtë faqe në internet.

4. ***myWorld*** beson fuqimisht në rëndësinë e trajtimit të kujdesshëm dhe konfidencial të të dhënave personale. Në rastet kur përdoruesi është në gjendje të fusë të dhëna personale ose të biznesit (adresat e email, emrat, adresat) në faqen e internetit, përdoruesi i jep këto të dhëna në mënyrë të shprehur vullnetare.

5. Ky përjashtim konsiderohet si një përbërës i faqes së internetit. Nëse pjesë ose fraza të vetme në këtë dokument nuk përkojnë, nuk korrespondojnë plotësisht ose nuk përputhen më me situatën aktuale ligjore, pjesa e mbetur e këtij dokumenti dhe përmbajtja dhe vlefshmëria e tij mbeten të paprekura.

6. Për më tepër, ***myWorld*** nuk është përgjegjës për përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit të publikuar në faqen e saj të internetit. ***myWorld*** nuk është përgjegjës për dëmet që lindin nga një përmbajtje e tillë. Autori i komenteve / vlerësimeve të çdo lloji të publikuara në faqen kryesore në internet është përgjegjës për kontributin e tij. Në rast të shkeljes së të drejtave të palëve të treta, personi përgjegjës për shkeljen duhet të shkarkojë ***myWorld*** nga përgjegjësia. ***myWorld*** rezervon të drejtën për të fshirë çdo përmbajtje të paligjshme ose imorale ose çdo përmbajtje tjetër që konsiderohet nga ***myWorld*** si i papërshtatshëm; asnjë pretendim nuk mund të ngrihet kundër ***myWorld*** lidhur me sa më sipër.